

DEPARTAMENTI



I OPERACIONEVE MONETARE

BANKA E SHQIPËRISË

Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” i jep institucionit të bankës qendrore të drejtën të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë politikën monetare. Për zbatimin e politikës monetare janë vënë në përdorim një sërë instrumentesh të cilat mund të kategorizohen në instrumente direkte dhe indirekte. Sot, Banka e Shqipërisë përdor vetëm instrumentet indirekte. Zbatimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë sigurohet nëpërmjet aktivitetit të Departamentit të Operacioneve Monetare.

A - Departamenti ka për detyrë të veprojë në tregun e hapur me qëllim që të sigurohet arritja e objektivave të politikës monetare. Kryesisht veprimet në tregun e hapur realizohen nëpërmjet organizimit të ankandeve javore të marrëveshjeve të riblerjes (repo) ose atyre të anasjellta. Norma e interesit e këtij instrumenti konsiderohet si norma bazë. Nga ana tjetër, për të rregulluar likuiditetin në sistemin bankar për afate të shkurtra kohe, me synim mbajtjen e normës afatshkurtër të interesit brenda një bande të pranueshme, Departamenti ofron për bankat e nivelit të dytë edhe depozitat dhe kreditë me afat njëditor (*standing facility*). Ndërsa, për të administruar likuiditetin e sistemit bankar për një afat më të gjatë kohe ai përdor repo ose repo të anasjelltë (kur likuiditeti synohet të administrohet përkohësisht) dhe blerje ose shitje përfundimtare të bonove të thesarit (kur kemi ndryshim të përhershëm strukturor në sistem).

Gjithashtu, rezerva e detyrueshme (10 %) dhe kredia lombard janë instrumente më pak fleksibile në dispozicion të Departamentit.

B - Veprimet në tregun valutor realizohen kryesisht nëpërmjet shitjes dhe blerjes *spot*, të valutave (kryesisht euro dhe usd). Pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë në tregun e këmbimeve valutore bëhet në ato raste kur zhvillimet në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore mund të çojnë funksionimin normal të tregut në periudhë afatshkurtër (për shembull kur vihen re lëvizje ekstreme në kërkesën/ ofertën për valutë në treg, lëvizje të shpejta dhe të çrregullta të kursit të këmbimit etj..). Në çdo rast, pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, kryhet duke respektuar regjimin e kursit të lirë të këmbimit.

C - Banka e Shqipërisë, me ligj, luan edhe rolin e agjentit fiskal, rol i cili, përmbushet po nga veprimtaria e Departamentit të Operacioneve Monetare. Ky funksion konsiston kryesisht në:

- Kryerjen e ankandeve primare për emetimin e bonove të thesarit me afat maturimi 3, 6 dhe 12 muaj. Në këto ankande kanë mundësi për të marrë pjesë pa kufizim rezidentë dhe jorezidentë. Me qëllim përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj individëve gjatë vitit të kaluar është krijuar edhe zyra e sportelit të bonove të thesarit, pranë po këtij Departamenti, në të cilën realizohen dhe mblidhen kërkesat për pjesëmarrje në ankandin primar të bonove të thesarit.
- Mbajtjen e llogarisë së qeverisë dhe reflektimi në të të gjitha lëvizjeve (hyrjeve, të ardhurave dhe daljeve, shpenzimeve) që realizohen nga bankat e nivelit të dytë të zgjedhura nga Ministria e Financave.
- Kreditimin direkt të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (nëpërmjet Ministrisë së Financave) brenda limiteve të pëcaktuara në ligjin nr. 8269, datë 23,12,1997 “Për Bankën e Shqipërisë”.
- Kryerjen e veprimeve valutore në emër dhe për llogari të Ministrisë së Financave. Kjo konsiston kryesisht në pagesat në kuadrin e shërbimit të borxhit të jashtëm, të transferimit të fondeve të ndryshme në pronësi të saj si dhe blerje/shitje valute me partner Ministrinë e Financave.

D - Departamenti kryen edhe veprime të tjera siç janë:

- Administrimi i rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë. Ky synon në administrimin e likuiditeteve valutore të bankës duke siguruar disponibilitetin e tyre në çdo moment, sigurinë e tyre si dhe realizimin e një fitimi.
- Veprimtaria në drejtim të evidentimit të borxhit të jashtëm të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Kjo lidhet kryesisht me evidentimin e shifrave të borxhit të vjetër të trashëguar, i përfituar para vitit 1992.

Arritjet në Departamentin e Operacioneve Monetare, kanë një spektër të gjerë dhe gjejnë shprehjen e tyre konkrete në drejtimet e mëposhtme:

- a) Përmirësimin e cilësisë së operacioneve që lidhen me zbatimin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Kjo ka evoluar së bashku me mënyrën e konceptimit dhe të zbatimit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, duke konfiguruar instrumente të reja, të përdorura gjerësisht edhe nga bankat më të mirënjohura të vendeve të zhvilluara. Ky proces është realizuar në kushtet e një tregu ndërbankar gjithnjë në evolucion.
- b) Rritjen e rolit të bankave në tregun e këmbimeve valutore, duke rritur kështu cilësinë e këtij aktiviteti si edhe rritjen e rolit të Bankës së Shqipërisë në këtë treg nëpërmjet rritjes së reputacionit të saj.
- c) Arritjet kanë qenë të konsiderueshme edhe në drejtim të administrimit të rezervës valutore. Politika dhe mënyra e administrimit të rezervës valutore, dokumenti bazë i cili rregullon këtë proces dhe që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, ka njohur rishikime të vazhdueshme duke reflektuar qëndrimin e Bankës së Shqipërisë ndaj mënyrës së investimit dhe nivelit të rrezikut që sipërmerr. Pikërisht për kontrollin e këtij të fundit, është përmirësuar mënyra e marrjes së vendimeve si dhe kontrolli i zbatimit të tyre nëpërmjet krijimit të hallkes së Komitetit të Investimit si dhe funksionimit të Sektorit të "Middle office".
- d) Vlen të përmenden edhe arritjet në drejtim të përmirësimit të mënyrës së emetimit të bonove të thesarit në tregun primar si edhe në drejtim të rritjes së numrit të pjesëmarrësve e veçanërisht të rritjes së numrit të individëve.

Në vazhdim të përmirësimit të aktiviteteve të kryera në Departament, gjatë viteve të ardhme, do të synohet kryesisht:

- a) Përafrimi i instrumenteve të politikës monetare me ato të përdorura nga Banka Qendrore Evropiane.
- b) Përmirësimi i aftësive parashikuese për likuiditetin e sistemit.
- c) Rritja e transparencës në lidhje me veprimet e kryera në Departament.
- d) Nxitja e mëtejshme e bankave të nivelit të dytë në drejtim të zhvillimit të tregut ndërbankar dhe atij të këmbimeve valutore.
- e) Rritja më tej e profesionalizmit në administrimin e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë.